



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2075 Prot

Vlorë, më 20.02 2023

Lënda: Njoftim për mbledhjen e këshillit të bashkisë, datë 24 shkurt 2023.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORË

PREFEKTIT TË QARKUT VLORË

Ju njoftoj se, **ditën e premte , datë 24.02. 2023, ora 10:00**, në pallatin e kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryetarja e këshillit, në bazë të ligjit nr. 139/2015, neni 53 pika 4, me këtë

REND DITE :

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë , datë 18.01.2023 dhe datë 31.01.2023 .
2. Miratimi i projektvendimit “ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin janar 2023”.
3. Miratimi i projektvendimit “ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin janar 2023”.
4. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e dokumentit të punës , për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen “.
5. Miratimi i projektvendimit “ Për miratimin e listës për fëmijët e familjeve me probleme të thella social ekonomike që do të frekuentojnë çerdhet dhe kopshtet me drekë për

një periudhë 10 mujore, me të ardhurat e bashkisë “.

6. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese për “Programin e përmirësimit të kushteve të banesave egzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara “për vitin 2023.
7. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e deklaratës për bashkëfinancim, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për “Programin e përmirësimit të kushteve të banesave egzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara “.
8. Informacion nga administrata e Bashkisë Vlorë, mbi marrjen e masave për çështjet e përcjella nga institucioni i prefektit të Qarkut Vlorë, si problematike dhe emergjente.
9. Të ndryshme.

Konferenca e Kryetarëve, do të zhvillojë mbledhjen **ditën e enjte**, datë **23.02.2023**, në mjediset e bashkisë Vlorë, në orën **09:00**.

Komisionet e përhershme do të mbledhen po në mjediset e bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike do të mbledhet **ditën e enjte**, datë **23.02.2023**, ora **09.30**

Komisioni i ekonomisë, financave dhe privatizimeve, do të mbledhet **ditën e enjte**, datë **23.02.2023**, ora **10.00**.

Komisioni i shërbimeve publike, transportit dhe strehimit, do të mbledhet **ditën e enjte**, datë **23.02.2023**, ora **10.30**.

KRYETARE

Migena Balla

